



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Emri i biznesit:** VALNET SH.P.K.  
**Numri Unik identifikues:** 811907114  
**Pronar:** Valon Bytyqi  
**Kandidati për licencë:** “VALNET SH. P.K”  
**Platforma:** IPTV  
**Adresa:** Opterushë, Rahovec



**VE N D I M**

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, “VALNET SH.P.K”, sipas platformës Operator i Shpërndarjes, me seli në Opterushë, Komuna e Rahovecit

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2020/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati “VALNET SH.P.K” më datën 09.12.2022, ka aplikuar për licencë të KPM-së, për Operatorë të Shpërndarjes së ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale sipas platformës kabllore.

**Arsyetim**

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”.


6. Për shkak të mungesës së vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e “VALNET SH.P.K” nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.
7. KPM, i ka ofruar kandidatit për licencë për operator të shpërndarjes “VALNET SH.P.K”të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2020/01) Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (Rregullorja KPM-2017/06) dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
8. Komisioni vlerëson se kandidati “VALNET SH.P.K” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2020/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim, me përjashtim të planit të biznesit.
9. Me Rregulloren KPM-2020/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Komisioni KPM-se vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 5, 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2012/01, ndërsa, kandidati “VALNET SH.P.K” ka dorëzuar një listë prej 9 kanaleve, si pjesë e katalogut programor.
10. Kandidati “VALNET SH.P.K” për operator të shpërndarjes sipas platformës Kabllore, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2020/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit.
11. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator të shpërndarjes “VALNET SH.P.K” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën e tij, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati “VALNET SH.P.K” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
12. Komisioni vlerëson se, kandidati “VALNET SH.P.K” ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2020/01 si dhe me Rregulloren KPM-2017/06, për t’u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
13. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator të shpërndarjes “VALNET SH.P.K” ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së, me kusht të dorëzimit të planit të detajuar dhe të kompletuar të biznesit.

### Vendim

14. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 23 qershor 2023 merr vendim që, kandidatit “VALNET SH.P.K” i cili planifikon të operojë në disa fshatra të Komunës së Rahovecit, t’i lëshojë licencën e KPM-së për operator të shpërndarjes sipas platformës IPTV për të ofruar shërbime të programeve në pajtim me katalogun e ofruar programor sipas marrëveshjeve

për të drejtat autoriale të atyre shërbimeve mediale audiovizuale, me kusht që brenda afatit më të shkurt kohorë të dorëzoj planin e detajuar dhe të kompletuar të biznesit.

15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



23.06.2023

datë